



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.589 Prot.

Tiranë, më 15 .04 . 2024

### V E N D I M

**Nr. 99 , datë 15 .04. 2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>2</sup>, mori në shqyrtim ankesën nr.178 regj, datë 25.09.2023, paraqitur nga ankuesi z. A.Ll<sup>3</sup> kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit, në të cilën pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi shpjegon se, është i datëlindjes 31.10.1969, lindur në Memaliaj, Tepelenë dhe banues në Tiranë. Është kryefamiljar, babai i 2 vajzave përkatësisht të moshës 20 dhe 24 vjeç. Në cilësinë e kryefamiljarit, është burimi kryesor i të ardhurave në familje.

Ankuesi shpjegon se, në datën 21.01.2021 është punësuar magazinier në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, ku ka punuar deri në vitin 2023. Ka punuar me përpikmëri, është vlerësuar pozitivisht dhe nuk ka patur asnjë vërejtje gjatë periudhës që ka punuar.

Në datën 17.02.2023, është thirrur në zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm z. H.Rr, i cili i ka kërkuar të marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet e vitit 2023. Për arsye familjare ankuesi shpjegon se, nuk ka marrë pjesë në fushatën zgjedhore, dhe pas datës 31.05.2023, është thirrur nga z. H.Rr, i cili i ka kërkuar që të nënshkruaj dorëheqjen. Kjo gjë është kundërshtuar nga ankuesi, por

1 Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

2 Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

3 Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Ankuesi.

sipas pretendimeve të tij është kërcënuar nga z.Rrapaj, i cili është shprehur që do të gjejë çdo mënyrë për ta larguar nga detyra. Është kontrolluar për punën që ka bërë dhe pa asnjë lloj arsye e shpjegimi ose komunikimi i është ndryshuar profili i punës nga detyra magazinier, në detyrën teknik i mesëm në terren. Urdhri është miratuar në datën 23.06.2023 dhe i është komunikuar 26.06.2023, detyrë të cilën e ka vijuar në mënyrë korrekte.

Pas një periudhe 2 mujore, në datën 31.08.2023, është marë vendimi për largimin e tij nga detyra, urdhër i cili ka hyrë në fuqi në datën 31.08.2023, me motivacionin për braktisje të punës, që sipas ankuesit është e pabazuar. Njoftimi i është vënë në dispozicion ditën e fundit të largimit nga puna. Burimet Njerëzore kanë refuzuar t'i japin dokumentat e nevojshme për t'a ndjekur kërre çështje në rrugë ligjore.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në vendin e punës si magazinier.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet: *"Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës,*

trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Bazuar në nenin 9, pika 1, të Kodit të Punës, që përbën dhe legjislacionin mbi bazën e të cilit është rregulluar marrëdhënia e punësimit në rastin konkret, parashikohet: “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.” Në bazë të pikës 2, të po këtij neni, përcaktohet se, me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet ndër të tjera, në bindjet politike, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Në nenin 5, pika “c”, të nenit 9, të Kodit të Punës, parashikohet: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:.....c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri vlerësoi se, ankesa e paraqitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pikat 3 dhe 4, të LMD dhe u pranua për shqyrtim. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1030/1 prot., datë 26.09.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , pranë Bashkisë Tiranë, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë. Me shkresën nr.3009/1 prot., datë 09.10.2023<sup>4</sup>, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , pranë Bashkisë Tiranë ktheu përgjigje në lidhje me ankesën duke parashtruar si më poshtë:

Ankuesi A.LI ka filluar marrëdhënien e punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në datën 19.01.2021, mbështetur në Urdhërin nr.163, datë 19.01.2021 “*Emërim në punë*” në pozicionin e magazinierit. Më datë 20.01.2021 mes palëve është lidhur kontrata individuale e punës me një periudhë tre mujore (koha e provës) dhe pas përfundimit të kohës së provës në datën 20.04.2021 është lidhur kontrata individuale e punës për punonjësin A.LI.

Z. A.LI nuk është paraqitur në vendin e punës nga data 21.08.2021 deri në datën 25.08.2023. Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë raport mjekësor apo arsye për mosprezencën e tij në punë, fakt që e vërtetojmë me kohëshënuesin e muajit gusht të cilin do e gjeni bashkëngjitur ku është shënuar në mungesë.

<sup>4</sup> Shkresa është administruar pranë Komisionerit me nr.1030/2 prot., datë 09.10.2023.

Më datë 23.08.2023 është mbajtur procesverbal konstatimi me nr.2507 prot, datë 23.08.2023, mbi kontrollin në punë të punonjësve, realizimin e detyrave dhe zbatimin e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë, është konstatuar mungesa e z.A.LI i cili nuk është paraqitur në punë dhe nuk ka njoftuar përgjegjësin e sektorit përkatës për mungesën e tij, duke u bërë pengesë për vijueshmërinë normale të punës.

Referuar shkresës me nr.2507/1 prot datë 25.08.2023 lënda “*Propozim për lirim nga detyra*” nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Ndriçimit Publik, është vënë në dijeni Drejtori i Përgjithshëm për mosprezencën e ankuesit në punë. Me procesverbalin nr.2507/2 prot datë 25.08.2023 është bërë “*Zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës nga punëmarrësi*”. Me urdhërin Nr.2530 prot datë 25.08.2023 është liruar nga detyra z. A.LI me shkakun e braktisjes së punës.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit z. A.LI se ka kërkuar nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore dokumentat për ta ndjekur këtë çështje në rrugë ligjore është e pabazuar. Sektori i Burimeve Njerëzore në institucionin tonë i përgjigjet çdo individ i cili kërkon dokumenta dhe të dhëna personale sipas përcaktimeve ligjore të Kodit të Punës së RSH dhe Rregullores së Brendshme të institucionit.

Nuk është aspak i vërtetë pretendimi i ankuesit se punëdhënësi e ka vënë në pozita diskriminuese për shkak të bindjeve politike, pasi marrëdhënia e punës është zgjidhur për shkelje të rënda të përsëritura disiplinore (braktisje e vendit të punës) nga ana e punonjësit. Nuk është aspak i vërtetë pretendimi i ankuesit A.LI se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike.

Për sa i përket informacionit nëse ka punonjës të tjerë, të cilëve i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës pas zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023, nuk kemi informacion dhe ankesa të tjera mbi këtë pretendim. Pozicioni i punës I mbajtur nga ankuesi është zëvendësuar.

2. Në datën 13.10.2023, ankuesi paraqiti (depozituar me postë elektronike, *e-mail* datë 13.10.2023) kundërshtimet e tij në lidhje me përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, duke iu qëndruar të njëjtave parashtrime si në ankesë.
3. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar*”, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 12.12.2023 ora 10:00. Zhvillimi i seancës dëgjimore i’u njoftua palëve me shkresën nr. 1030/3 prot., datë 15.11.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e ankuesit, i cili mori pjesë personalisht dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga z.J. H, jurist, sipas autorizimit nr.4042 prot datë 06.12.2023, lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë.

Gjatë seancës dëgjimore ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra me dije gjatë komunikimit shkresor dhe kërkoi rikthimin e tij në punë si magazinier ose në një punë tjetër të përshtatshme.

Gjatë seancës dëgjimore z. Hasho, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë duke i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra me dije gjatë komunikimit shkresor. Për shkak se Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, pranë Bashkisë Tiranë nuk kishte depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri, gjatë seancës iu la detyrë që në vijim të paraqiste të gjitha aktet e kërkuara.

4. Me shkresën nr.119 prot datë 22.01.2024, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë duke kërkuar depozitimin pranë Komisionerit të të gjithë informacionit të kërkuar me shkresën nr.1030/3 prot, datë 15.11.2023, i cili ishte dorëzuar i plotë si dhe aktet e kërkuara gjatë seancës dëgjimore, në lidhje me planet e punës për ditët që pretendohet se ankuesi nuk është paraqitur në punë, informacion në lidhje me nevojat e institucionit për të ndryshuar vendin e punës së ankuesit nga “magazinier” në “teknik” dhe diferencat në pagë midis këtyre pozicioneve.

Me shkresën nr. 293/1 prot datë 30.01.2024<sup>5</sup>, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë ktheu përgjigje, duke parashtruar ndër të tjera si më poshtë:

Së pari, në lidhje me ndryshimin e pozicionit të punës, pozicioni i Teknikut të mesëm ka pagë më të lartë në bazë të kategorive V dhe VI (vendimi nr.50, datë 03.05.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë), ku paga e teknikut të mesëm është në vlerën 43.200 lekë ndërsa paga e magazinierit është 42.800 lekë Konkretisht ankuesi sipas listëpagesës së muajit maj 2023 dhe muajit korrik 2023 ka marrë respektivisht pagat 42.182 lekë për muajin Maj 2023 dhe pagën 43.190 lekë për muajin Korrik 2023. Pra ankuesi është paguar më tepër pas ndryshimit të pozicionit të punës.

Në bazë të Urdhrit me nr.1919 prot., datë 23.06.2023 është ngritur komisioni për dorëzimin e aktiviteteve të magazinës së sinjalistikës rrugore nga ana e ankuesit dhe ka vazhduar me shkresën nr. 1919/1 prot datë 23.06.2023 dhe me procesverbalin me nr.1919/2 prot., datë 23.06.2023 dhe procesverbalin nr.1919/3 prot datë 23.06.2023, ku u krye inventarizimi i plotë duke numëruar një për një çdo artikull, material dhe mjete kryesore, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nga ana e ankuesit nuk ka patur asnjë ankim në institucion dhe inventarizimi i materialeve të cilat i kishte në ngarkim është kryer pa asnjë pengesë, si dhe ka firmosur dorëzimin e materialeve, mjeteve dhe artikujve që kishte në ngarkim. Për sa i përket ndryshimit të pozicionit të punës nuk ka pasur pretendime në momentin që ka ndodhur lëvizja.

---

<sup>5</sup> Shkresa është administruar pranë Komisionerit me nr.119/1 prot., datë 31.01.2024.

Së dyti, po ju depozitojmë urdhrat e punës të datave 21.08.2023, 22.08.2023 dhe 23.08.2023, ku nga ana e Drejtorisë së Ndriçimit Publik urdhërohen të merren masa për realizimin e punëve konform kushteve teknike dhe brenda afateve të caktuara. Përgjegjësi i Sektorit ka deponuar që, punëtorët e grupit të tij mbledheshin çdo ditë në vendin e caktuar nga ana e drejtorisë dhe nga ana e tij iu dorëzohej plani i punës secilit dhe procedohej më pas me punët e parashikuara sipas urdhrat. Në ditët për të cilat janë subjekt hetimi, ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës të caktuar prej përgjegjësit të sektorit, te dispeçeria pranë rrugës Dedë Gjo Luli, në këto kushte është shënuar dhe mungesa në kohëshënuesin e dorëzuar.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, të LMD, si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se diskriminimi ka ndodhur, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën për punësim, duke përfshirë këtu edhe momentin e përfundimit të marrëdhënieve të punës;
- në krahasim me sesi janë trajtuar, trajtohen ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme, dhe;
- arsyeja për këtë trajtim është një/disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje ligjore nga diskriminimi.

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse pala ankuese është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet krahasuesi. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me parashikimet ligjore që normojnë marrëdhënien mes tij dhe punëdhënësit. Pra, për të vërtetuar sjelljen diskriminuese, nuk është e nevojshme në çdo rast



identifikimi i një krahasuesi konkret, por kërkesat për të provuar se pala ankuese i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, konsiderohen të përmbushura edhe nga një krahasues hipotetik, që në rastin konkret është mënyra se si Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë në cilësinë e punëdhënësit, duhet të kishte respektuar standartet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga Kodi i Punës, për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin.

Në Komentin e Përgjithshëm nr.20, “Për mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, pika 10, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kuturore në vitin 2009, parashikohet se: “...Diskriminimi i drejtëpërdrejtë përfshin gjithashtu veprime ose mosveprime të dëmshme mbi bazën e një shkakut të mbrojtur, kur nuk ka një situatë të ngjashme të krahasueshme”.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve politike të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për punësim dhe më konkretisht në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës dhe largimin nga puna.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, ankuesi A.Ll ka filluar punë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën 19.01.2021, në pozicionin e magazinierit në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe menaxhimit të Shërbimeve, fakt ky që rezulton i provuar nga urdhri “Për emërim në detyrë” me nr.163 prot datë 19.01.2021. Më datë 20.01.2021, midis ankuesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik është lidhur kontrata individuale e punës me nr.163/1 prot datë 20.01.2021. Në datën 20.04.2021, në përfundim të periudhës së provës, palët kanë nënshkruar kontratën individuale të punës me nr.163/2 prot datë 20.04.2021, kontratë e cila është lidhur për një kohëzgjatje të pacaktuar (neni 4, pika 1 e Kontratës individuale).

Marrëdhëniet e punës midis ankuesit në pozicionin si magazinier dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik kanë vijuar normalisht. Gjatë periudhës që ankuesi ka ushtruar detyrën si magazinier nuk rezulton që ndaj tij të jetë marrë ndonjë masë disiplinore. Bazuar në vlerësimet vjetore të rezultateve në punë për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se ankuesi është vlerësuar me 1 (një) “shumë mirë”, që përbën vlerësimin më të lartë.

Nga aktet e administruara rezulton se, bazuar në urdhrin nr.1919 prot., datë 23.06.2023 “Për ngritje Komisioni për dorëzimin e aktiveve të magazinës së sinjalistikës rrugore nga z.A.Ll te z.A.Ti”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është urdhëruar: “Të ngrihet komisioni për kryerjen e inventarit të aktiviteteve në Magazinën Sinjalistikës Rrugore për kalimin e detyrës nga z.A.Ll tek z.A. T”. Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri, ka kryer veprimet përkatëse dhe referuar akteve të mbajtura gjatë procesit të dorëzimit të aktiveve të magazinës nga ana e ankuesit, konkretisht relacion nr.1919/1 prot, datë 23.06.2023,

procesverbal nr.1919/2 prot datë 23.06.2023 dhe procesverbal nr.1919/3 prot, datë 23.06.2023, rezulton se, gjatë dorëzimit të aktiveve të magazinës nuk është konstatuar asnjë parregullsi në ngarkim të ankuesit.

Në vijim të procesit të mësipërm për dorëzimin e aktiveve të magazinës nga ankuesi tek punonjësi A.T, rezulton se në bazë të urdhrin (nr. nuk ka dhe datë nuk ka) “Për lëvizje brenda organikës”, me nr.1919/4 prot datë 01.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, është urdhëruar: “1. Lëvizjen brenda organikës të punonjësit z.A.Ll nga detyra e magazinierit në Sektorin e Financës të Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në detyrën e teknikut të mesëm në Sektorin e Dispeçerisë të Drejtorisë së Ndriçimit Publik, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. 2. Pagesa sipas VKB nr.50, datë 03.05.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në vazëri të BT”, “Lidhja e pagave nr.3” është klasa VI. 3. Marrëdhëniet financiare fillojnë në datë 01.07.2023.....”. Ndërkohë me urdhrin (nr. dhe datë nuk ka) “Për lëvizje brenda organikës” me nr.1919/5 prot, datë 01.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, është urdhëruar: “ 1. Lëvizjen brenda organikës të punonjësit z.A.T nga detyra e teknikut të mesëm në Sektorin e Dispeçerisë të Drejtorisë së Ndriçimit Publik, në detyrën e magazinierit në Sektorin e Financës të Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. 2. Pagesa sipas VKB nr.50, datë 03.05.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në vazëri të BT”, “Lidhja e pagave nr.3” është klasa V. 3. Marrëdhëniet financiare fillojnë në datë 01.07.2023.....”. Ankuesi ka vijuar punën në pozicionin e ri të punës, si teknik i mesëm, në Sektorin e Dispeçerisë të Drejtorisë së Ndriçimit Publik. Palët nuk rezulton që të kenë nënshkruar një kontratë individuale pune për pozicionin teknik i mesëm, në Sektorin e Dispeçerisë të Drejtorisë së Ndriçimit Publik.

Nga aktet e administruara rezulton se, në datën 23.08.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, është mbajtur “Procesverbal konstatimi” me nr.2507, datë 23.08.2023, nga ana e znj.R.Xh, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, z. E.Rr, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Dispeçerisë dhe z.E.I, Specialist i Sektorit. Në këtë procesverbal citohet se: “...Pas kontrolleve rutinë të kryera nga personat përgjegjës për mbarëvajtjen e punës, që prej datës 21.08.2023 e në vijim të javës së punës, rezulton se z.A.Ll nuk është paraqitur në punë e nuk ka njoftuar përgjegjësin ose specialistin e sektorit përkatës për mungesën e tij, duke u bërë pengesë për vijueshmërinë normale të punës. Kontrolli konsiderohet i mbyllur. ....Bashkëngjitur procesverbalit të konstatimit gjendet propozimi për shkëputje fillim të procedurës disiplinës për punonjësin e sipërpërmendur, sipas të gjitha rrethanave të shkeljeve.” Bashkëlidhur “Procesverbalit të konstaimit” gjendet shkresa nr.2507/1 prot, datë 25.08.2023 me lëndë “Propozim për lirim nga detyra”, të cilën Drejtori i Drejtorisë së Ndriçimit Publik ia drejton Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik. Në këtë shkresë, relatohet si vijon: “ Në bazë të Ligjit 7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në vijim të procesverbalit të Konstatimit nr.2507 prot datë 23.08.2023, pas kontrolleve rutinë të kryera nga personat përgjegjës për mbarëvajtjen e punës që prej datës 21.08.2023 e në vijim të javës, si edhe pas përpjekjeve të përgjegjesit të sektorit për të kontaktuar me punonjësin A.Ll, rezulton se ai ka braktisur punën, duke shkaktuar dëm në relatimin në kohë të



*problematikave, sipas planit ditor të punës. Braktisja e punës pa shkaqe të arsyeshme, pa informuar eprorin për mungesën e tij, sjell pengesa në procesin e punës dhe është veprim i penalizueshëm. Duke vlerësuar shkallën e përgjegjësisë për mbarëvajtjen e punës propozoj lirim nga detyra.”*

Në vijim të shkresës “Propozim për lirim nga detyra” nr.2507/1 prot datë 25.08.2023, është mbajtur procesverbali me nr.2507/2 prot datë 25.08.2023, nga ana e z.S.M, Drejtor i Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, znj.R.Xh, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe znj.A.Xh, Specialiste. Në këtë procesverbal relatohet si vijon: “ I mbajtur sot në dt.25.08.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik në zbatim të Ligjit Nr.7961, dt.12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” neni 156, “Zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës nga punëmarrësi” drejtuar për njohje Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, z.H.Rr bazuar në :

1. Shkresën e Drejtorisë së Ndriçimit Publik, nr.2507/1 prot datë 25.08.2023, me lëndë: “Propozim për lirim nga detyra”;
2. Procesverbalin e konstatimit nr.2507 prot., datë 23.08.2023;
3. Listëprezencën e Drejtorisë së Ndriçimit Publik;
4. Mungesës së njoftimit me shkrim nga punëmarrësi për mungesat në punë;
5. Kontrollit në sistemin digital E-Albania për raport mjekësor, konfirmojmë se: - Punonjësi A.Ll “nuk është paraqitur në vendin e punës nga data 21.08.2023 e në vijim, ka braktisur punën pa shkaqe të arsyeshme, nuk ka njoftuar me shkrim pundhënësin”.

Po në të njëjtën ditë, më datë 25.8.2023, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin (numër dhe datë nuk ka ) “Për lirim nga detyra” nr.2530 prot datë 25.8.2023, sipas të cilit është disponuar si vijon : “1. Z.A.Ll punonjës në Sektorin e Dispecerisë, në Drejtorinë e Ndriçimit Publik, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik zgjidhet Kontrata Individuale e Punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar nga punëmarrësi për braktisje të punës. 2. Të kryehet pagesë për leje të pakryer për vitin 2023 në masën \_\_\_\_ ditë pune. 3. Marrëdhëniet e punës dhe financiare ndërpriten me datë 29.8.2023.....” . Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik nuk u provua se kur ia ka komunikuar urdhrin për lirim nga detyra ankuesit, ndërsa ky i fundit deklaroi se ka marrë dënimin në datën 31.8.2023.

Ankuesi ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, pasi ndryshimi i pozicionit të tij të punës nga magazinier në teknik i mesëm dhe më pas zgjidhja e marrëdhënies së tij të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, ka ndodhur për shkak se nuk ka pranuar kërkesën e titullarit të këtij institucioni z. H.Rr, Drejtor i Përgjithshëm, për të marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet vendore të zhvilluara në maj të vitit 2023. Ankuesi pretendon se, motivacioni i largimit nga detyra për braktisje të punës është i pavërtetë, pasi ai ka qenë në detyrë dhe nuk është kontrolluar apo nuk e kanë telefonuar asnjëherë në lidhje me mungesën në punë, sikurse pretendohet.

Nga aktet e administruara rezulton se marrëdhënia e punës midis ankuesit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik për të dyja pozicionet e punës ku ai ka punuar, fillimisht magazinier dhe më pas teknik i mesëm, është rregulluar nga Kodi i Punës.

Nga aktet e administruara rezulton se ankuesi ka punuar në pozicionin magazinier nga data 20.1.2021 deri në datën 30.6.2023, kur në bazë të urdhrin nr.1919/4 prot datë 1.7.2023, ankuesi ka kaluar nga detyra si magazinier në detyrën e teknikut të mesëm. Ky ndryshim i pozicionit të punës, është konsideruar nga punëdhënësi si lëvizje brenda organikës. Referuar kontratës individuale të punës nr.163/2 prot datë 20.4.2021, rezulton se marrëdhënia e punës së ankuesit në pozicionin magazinier, është lidhur për një afat kohor të pacaktuar.

Referuar Kodit të Punës, në nenin 23, të tij përcaktohe forma e kontratës së punës dhe elementët që duhet të përmbajë ajo. Konkretisht në këtë dispozitë përcaktohet: *“1. Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë. 2. Kontrata e punës quhet e lidhur kur punëmarrësi pranon kryerjen e një pune ose shërbimi, për një periudhë kohe të caktuar ose të pacaktuar, brenda kuadrit të organizimit dhe sipas urdhrave të punëdhënësit dhe që, në bazë të këtyre rrethanave, kryhet vetëm kundrejt pagesës. 3. Kontrata e punës duhet të përmbajë sidomos: a) identitetin e palëve; b) vendin e punës; c) përshkrimin e përgjithshëm të punës; ç) datën e fillimit të punës; d) kohëzgjatjen, kur palët lidhin kontratë me afat të caktuar; dh) kohëzgjatjen e pushimeve të paguara; e) afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës; ë) elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj; 27 f) kohën normale javore të punës; g) referenca në kontratën kolektive në fuqi; gj) periudhën e provës; h) llojet dhe procedurat e masave disiplinore, nëse nuk ka kontratë kolektive.”*

Sa më sipër, rezulton se, vendi i punës, pozicioni (detyra) i punës dhe paga përbëjnë elementë thelbësorë të kontratës së punës, e cila mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët me vullnetin e tyre të ndërsjelltë bien dakort për ta bërë këtë.

Në rastin objekt shqyrtimi, rezulton se, punëdhënësi/Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , nëpërmjet urdhrin nr.1919/4 prot datë 1.7.2023 ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme pozicionin e punës së ankuesit nga magazinier në teknik i mesëm. Nga aktet e administruara rezulton se, ndryshimi i pozicionit të punës nga magazinier në teknik i mesëm shoqërohet me ndryshim në klase dhe në page. Konkretisht, referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.50 datë 3.5.2023 *“Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Tiranë”*, Lidhja Nr.3 *“Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik”*, rezulton se, pozicioni i punës “Magazinier” ka klasën V dhe pagë bazë 42 800, ndërsa pozicioni i punës “Teknik i mesëm” ka klasën VI dhe pagë bazë 43 200. Pra rezulton se, pozicioni “Teknik i mesëm” është një klasë më lartë se pozicioni “Magazinier” ndërsa rritja në pagë për rritjen me një klasë (nga klasa V në klasën VI) është vetëm 400 lekë. Pra, në pozicionin “Teknik i mesëm” ankuesi përfiton 400 lekë më shumë në raport me pozicionin “Magazinier”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, punëdhënësi/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme dhe pa marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim të ankuesit, elementë të tillë të kontratës së punës, si vendi i punës, pozicioni (detyrat) i punës dhe paga (ndryshim i vogël, vetëm 400 lekë).

Referuar shkresës nr.1919/4 prot datë 1.7.2023, të punëdhënësit/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nuk jepet asnjë motivacion në lidhje me shkaqet që e kanë detyruar punëdhënësin/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë që të ndryshojë në mënyrë të menjëhershme dhe të njëanshme pozicionin e punës së ankuesit nga “magaziner” duke e kaluar në pozicionin “teknik i mesëm”. Gjithashtu gjatë shqyrtimit nuk rezultoi e provuar, por as nuk u pretendua se ankuesi është larguar nga pozicioni i punës magazinier pasi kishte shkelur detyrimet kontraktuale me faj të rëndë, kishte shkelur detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit apo se kishte patur një performancë jo të mirë në punë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, punëdhënësi/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, nuk dha arsye objektive dhe të justifikuar në lidhje me nevojën për ndryshimin e pozicionit të punës së ankuesit nga “magaziner” në “teknik i mesëm”. Përkundrazi, rezultoi se, gjatë kohës që ka ushtruar detyrën si magazinier ankuesi është vlerësuar në dy vlerësime radhazi 2021 dhe 2022 me vlerësimin “shumë mirë” dhe gjatë akteve të mbajtura për dorëzimin e aktiveve të magazinës tek punonjësi A.T, nuk është konstatuar asnjë mangësi apo parregullsi gjatë kohës që ankuesi ka ushtruar detyrën si magazinier.

Referuar akteve të vendosura në dispozicion nga Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, konstatohet se, detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës “magaziner” dhe “teknik i mesëm” janë shumë të ndryshme. Konkretisht, referuar detyrave dhe përgjegjësiave të vendosura në dispozicion në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e teknikut të mesëm, konstatohet se ky pozicion pune, përmban aspekte teknike që kanë nevojë për mjete mbrojtëse apo marrjen e masave tekniko-organizative për kryerjen e punimeve konform rregullave të sigurimit teknik.

Gjatë shqyrtimit, punëdhënësi/ Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me arsyet, nevojën apo përmbushjen e kërkesave të imponuara nga detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushen nga një person i punësuar në pozicionin e teknikut të mesëm, për “lëvizjen brenda organikës” të ankuesit, sikurse e ka emërtuar urdhrin e saj për ndryshimin e pozicionit të punës së ankuesit nga magazinier në teknik i mesëm.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi deklaroi se ai ka qenë i detyruar për të vijuar punën në pozicionin “teknik i mesëm” pavarësisht se nuk ka qenë i kualifikuar për këtë pozicion pune, pasi i duhet të sigurojë të ardhura për familjen.

Rezulton se, nëpërmjet të njëjtit urdhër (nr.1919/4 prot datë 1.7.2023) që ankuesit i është zgjidhur marrëdhënia e punës për pozicionin si magazinier, ai është emëruar dhe ka kaluar në pozicionin e

punës teknik i mesëm, në Sektorin e Dispeçerisë të Drejtorisë së Ndriçimit. Nga aktet e administruara, palët nuk kanë nënshkruar një kontratë individuale pune për këtë pozicion pune. Për sa kohë që palët nuk kanë lidhur një kontratë pune me afat të caktuar, atëherë marrëdhënia e re e punës e vendosur nëpërmjet urdhrin të sipërcituar për pozicionin teknik i mesëm, do të konsiderohet si një marrëdhënie pune me afat të pacaktuar.

Bazuar në urdhrin për lirim nga detyra të ankuesit, konkretisht urdhri nr.2530 prot., datë 25.8.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit, konstatohet se motivacioni i zgjidhjes së kontratës së punës me ankuesin për pozicionin teknik i mesëm është se punëmarrësi, në rastin konkret ankuesi A.LI, ka zgjidhur kontratën individuale të punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, duke braktisur punën. Referenca ligjore e vendosur në urdhrin e lirimin nga detyra të ankuesit është neni 156 i Kodit të Punës.

Neni 156, i Kodit të Punës rregullon zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëmarrësi. Në pikën 1, të dispozitës së sipërcituar, sanksionohet se: *“1. Kur kontrata e punës zgjidhet nga punëdhënësi, për arsye se provohet se punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin, ajo konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar e kontratës së punës nga ana e punëmarrësit.....”*

Bazuar në dispozitën e mësipërme, që punëdhënësi të legjitimohet për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 156 të Kodit të Punës dhe kontrata e punës të konsiderohet si zgjidhje e pajustificuar nga ana e punëmarrësit duhet të provohet se:

punëmarrësi nuk paraqitet në vendin e punës, të caktuar në kontratën e punës, ose e braktis atë menjëherë;

mosparaqitja ose braktisja e vendit të punës ka ndodhur pa shkaqe të arsyeshme

mosparaqitja ose braktisja e vendit të punës ka zgjatur minimalisht 7 ditë;

mungesa e njoftimit me shkrim nga ana e punëmarrësit drejtuar punëdhënësit.

Midis palëve nuk është nënshkruar një kontratë individuale pune për pozicionin teknik i mesëm, për të përcaktuar se cili është vendi i punës ku duhet të paraqitet ankuesi. Referuar akteve të administruara në lidhje me detyrat e përgjegjësitë e pozicionit teknik i mesëm si dhe deklarimeve të palëve gjatë shqyrtimit të ankesës, konstatohet se, detyra teknik i mesëm është një detyrë e cila realizohet në terren, mbi bazën e planeve të punës dhe ndarjes së detyrave nga personat përgjegjës.

Punëdhënësi/Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit, Bashkia Tiranë pretendon se ankuesi nuk është paraqitur në punë, pa shkaqe të arsyeshme dhe pa asnjë njoftim për punëdhënësin në lidhje me mungesën e tij në punës, nga data 21.8.2023 deri në datën 25.8.2023, kur ka dalë urdhri për largimin e tij nga puna. Pra, rezulton se, gjithsej pretendohet se ankuesi nuk është paraqitur në punë 5 ditë, ndërsa neni 156 i K.Punës përcakton se minimalisht mosparaqitja ose braktisja e vendit të punës ka zgjatur të paktën 7 ditë.

Ankuesi kundërshton pretendimin e punëdhënësit/Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit sipas të cilit nuk është paraqitur në punë, duke prapësuar se ai në ditët e pretenduara ka qenë në vendin e punës që i është komunikuar nga eprori i tij dhe gjatë kësaj periudhe atij nuk i është komunikuar asnjëherë se nuk është gjetur në vendin e punës sipas kontrolleve që pretendohet se janë kryer. Ai deklaron se ka marrë dijëni në lidhje me pretendimin se ka braktisur vendin e punës vetëm në datën 31.8.2023, kur i është komunikuar urdhri për lirim të tij nga detyra si teknik i mesëm.

Punëdhënësi/Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit, Bashkia Tiranë pretendoi se, për ditët e pretenduara që ankuesi nuk është paraqitur në vendin e punës, ky i fundit duhet të ishte paraqitur në vendin e punës të përcaktuar nga përgjegjësi i sektorit, konkretisht tek dispeceria pranë rrugës Dedë Gjo Luli, por ankuesi nuk është paraqitur dhe për këtë arsye është shënuar mungesa e tij në kohëshënuesin e dorëzuar.

Nga aktet e administruara nuk rezulton e qartë dhe e provuar se si ankuesi është njohur paraprakisht me detyrat dhe vendin e punës që duhet të kryejë, nga ana e përgjegjësit të sektorit, ndërkohë që ankuesi pretendon se është paraqitur në vendin e punës dhe ka kryer detyrat që i janë caktuar ndërsa punëdhënësi pretendon të kundërtën.

Nga aktet e administruara, nuk rezulton që mungesa në punë e ankuesit të jetë konstatuar për çdo ditë dhe të jetë komunikuar dhe të jetë bërë me dije ankuesit nga ana e eprorit të tij apo personave përgjegjës për disiplinën në punë. Akti fillestar që është mbajtur nga punëdhënësi /Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit, Bashkia Tiranë në lidhje me mungesën në punë të ankuesit, është procesverbal- konstatimi me nr. 2507, datë 23.8.2023. Në këtë procesverbal-konstatimi të mbajtur në datë 23. 8.2023, pasqyrohet se, mungesa në punë e ankuesit është konstatuar që prej datës 21. 8. 2023 e në vijim të javës së punës, bazuar në kontrollet rutinë të kryera nga personat përgjegjës për mbarëvajtjen e punës. Nga aktet e administruara nuk provohet se kur janë kryer këto kontrolle rutinë dhe nuk ka akte konstatimi të këtyre kontrolleve për periudhën e pretenduar që prej datës 21.8.2023. Në procesverbal konstatimin e datës 23.8.2023, deklarohet se, ankuesi nuk është paraqitur në punë pa njoftuar përgjegjësin ose specialistin përkatës prej datës 21.8.2023 e në vijim të javës së punës. Nëse i referohemi kalendarit për ditët e pretenduara, konstatohet se data 21.8.2023, korrespondon me ditën e parë të javës së punës, pra e hënë ndërsa data 23.8.2023 kur është mbajtur procesverbali i konstatimit, korrespondon me ditën e mërkurë. Konstatimi i bërë në procesverbalin e mbajtur në datë 23.8.2023, ditë e mërkurë, ku është konstatuar mungesa në punë e ankuesit, “që prej datës 21.8.2023 e në vijim të javës së punës”, ndërkohë që java e punës nis në datë 21.8.2023 dhe përfundon në datë 25.8.2023, që korrespondon me ditën e premte, dita e fundit të javës së punës, është i paqartë. Në mes të javës së punës, pra në datën e mbajtjes së procesverbalit datë 23.8.2023 nuk mund të konstatohet se ankuesi do të mungojë në punë për “ditët në vijim të javës së punës”.

Nga tërësia e akteve të administruara, në asnjë moment nuk rezulton e provuar se si, punëdhënësi ia ka komunikuar ankuesit mungesën e tij në punë për çdo ditë pune dhe se si është kontaktuar ankuesi nga punëdhënësi, sikurse pretendohet nga ana e punëdhënësit. Të gjitha aktet e mbajtura

nga ana e punëdhënësit nëpërmjet të cilave ai pretendon se ankuesi nuk është paraqitur në punës, janë akte të njëanshme të cilat nuk i janë bërë asnjëherë me dije ankuesit para zgjidhjes së marrëdhënies së tij të punës.

Referuar nenit 144 të Kodit të Punës, kur punëdhënësi kërkon të zgjidhë kontratën e punës është i detyruar të respektojë procedurën e përcaktuar në këtë dispozitë. Kjo procedurë është e zbatueshme në çdo rast, me përjashtim të pushimeve kolektive, sipas parashikimit që bëhet në pikën 6, të nenit 144, të Kodit të Punës. Sipas nenit 144 të Kodit të Punës, punëdhënësi është i detyruar t'i njoftojë paraprakisht punëmarrësit arsyet se përse punëdhënësi kërkon të zgjidhë kontratën e punës. Në këtë dispozitë përcaktohet procedura konkrete dhe afatet, se si realizohet ky komunikim midis punëdhënësit dhe punëmarrësit. Procedura duhet t'i mundësojë në mënyrë efektive punëdhënësit të drejtën që pasi të jetë njohur me arsyet për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, të ketë të drejtën të dëgjohet dhe të mbrohet.

Pika 5/1, e nenit 144, të Kodit të Punës përcakton qartë se është detyrim i punëdhënësit që të provojë se ka respektuar procedurën e parashikuar nga kjo dispozitë. Në këtë kuptim punëdhënësi/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , ka barrën e provës që të provojë arsyen/arsyet mbi bazën e të cilave zgjidhet marrëdhënia e punës, pra të provojë se ankuesi nuk është paraqitur në punë për ditët e pretenduara. Gjatë shqyrtimit të ankesës punëdhënësi/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë nuk arriti të provojë se e ka njoftuar paraprakisht ankuesin lidhur me arsyet e zgjidhjes së kontratës së punës për pozicionin teknik i mesëm dhe të ketë siguruar të drejtën e ankuesit që të dëgjohet dhe të mbrohet.

Për gjithë sa më sipër, nuk rezulton e provuar që ankuesi në cilësinë e punëmarrësit nuk është paraqitur në vendin e punës, pa shkaqe të arsyeshme, dhe brenda 7 ditëve nuk ka njoftuar, me shkrim, punëdhënësin. Në këto kushte, punëdhënësi/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit, nuk legjitimohet që të zgjidhë kontratën e punës me ankuesin në pozicionin teknik i mesëm me motivacionin se ankuesi në cilësinë e punëmarrësit ka zgjidhur në mënyrë të pajustificuar kontratën e punës, duke braktisur punën.

Komisioneri vlerëson se, arsya e deklaruar nga punëdhënësi Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , Bashkia Tiranë për zgjidhjen e kontratës së punës së ankuesit për pozicionin teknik i mesëm, rezultoi e paprovuara. Në këto kushte provohet se, largimi nga puna i ankuesit A.Ll, është bërë pa shkaqe të arsyeshme dhe objektive, si dhe në shkelje të procedurës ligjore që duhet ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi A.Ll është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit/Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.

## **B. Shkaku i mbrojtur**



Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm, përbën diskriminim dhe gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas LMD.

Në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi A.LI pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*”. Në lidhje me pretendimin për diskriminim në kuadër të shkakut të bindjeve politike, ankuesi pretendon se, ndryshimi i pozicionit të tij të punës nga magazinier në teknik i mesëm dhe më pas zgjidhja e marrëdhënies së tij të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, ka ndodhur për shkak se nuk ka pranuar kërkesën e titullarit të këtij institucioni z. H.Rr, Drejtor i Përgjithshëm, për të marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet vendore të zhvilluara në 14 maj 2023. Pra, ankuesi nuk pretendon se ka pikëpamje/bindje të caktuara politike, por se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme për shkak të mospasjes së bindjeve të njëjta politike me ato të titullarit të institucionit.

Në lidhje me shkakun e bindjeve politike, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, në vendimin nr. 31/2021, në pikën 67, të tij, shprehet se: *“...nacioni bindje politike përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkuadrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike.”*

Në këtë kontekst, Komisioneri, vlerëson si shkak të njohur nga LMD si “bindje politike” edhe mospasjen e bindjeve të caktuara politike<sup>6</sup>.

Ankuesi pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm duke u larguar fillimisht nga pozicioni i punës si magazinier dhe më pas duke u larguar përfundimisht nga puna me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pasi nuk ka pranuar nuk ka pranuar kërkesën e titullarit të këtij institucioni z. H.Rr, Drejtor i Përgjithshëm, për të marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste për zgjedhjet vendore të zhvilluara në maj të vitit 2023. Sipas ankuesit, titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, z.H.Rr, ka qenë i përfshirë dhe ka bërë fushatë në mbështetje të kësaj force politike. Në mbështetje të këtij pretendimi ankuesi ka depozituar foto nëpërmjet të cilave ka faktuar pjesëmarrjen e titullarit të institucionit z.H.Rr, në aktivitete politike të organizuara nga Partia Socialiste, gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve të vendore, të 14 Majit 2023<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Shiko: Vendimin e Komisionerit nr. 180, datë 23.09.2023 A.L kundër DRAP Lezhë, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/10/Vendim-nr.-180-date-23.09.2021-A.-L-kunder-DRAP-Lezhe-Diskriminim.pdf>,

<sup>7</sup> [https://www.facebook.com/story.php?story\\_fbid=10229328249420075&id=1513299799&mibextid=WC7FNe](https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=10229328249420075&id=1513299799&mibextid=WC7FNe)

Komisioneri vëren se, për kuptimin e përgjithshëm të mjeteve të provave i referohet parashikimeve të nenit 80, të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar, i cili kuptohet si jo kufizues lidhur me mjetet e provës për palët. Në këtë kuptim, pala mund të paraqesë para organit publik, çfarëdo lloj prove për të provuar se ka të drejtë gjatë vlerësimit të rrethanave të çështjes, përfshirë edhe fotot, të cilat janë çmuar nga Komisioneri në raport e harmoni me provat e rrethanat e tjera të çështjes.

Provat mund të jenë të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta. Në rastin e parë, provat çojnë drejt fakteve vendimtare, dhe në rastin e dytë, çojnë në fakte të cilat mund të shërbejnë si baza për arritjen e një përfundimi lidhur me një fakt vendimtar. Në këtë logjikë, rasti i dytë lidhet me pretendime që nuk faktohen vetëm me dokumenta me shkrim, por kanë të bëjnë me çdo material që është i përshtatshëm për të vërtetuar fakte apo për të konfirmuar deklaratat, të tilla siç mund të jenë dhe fotografitë.

Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, nga ana e palës ankuese, atë të mospasjes së “bindjeve politike”, në ndryshim nga z. H.Rr, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, pranë Bashkisë Tiranë, në kohën që ankuesi i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të disfavorshëm, i ka të ekspozuara haptazi bindjet e tij politike si përkrahës dhe mbështetës i fushatës së Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 14 Maj 2023.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, me shkakun e mbrojtur.**

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”*.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Në praktikën e saj, Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në*

*kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlijet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, trajtimi i diferencuar është diskriminues, nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet<sup>8</sup>.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës.

Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përlijtur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja)*, nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga GJEDNJ-ja si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”*. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin për shkak të bindjeve politike, në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të. Ndërkohë, Protokollu 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

*Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*<sup>9</sup>, sanksionon të drejtën për punë në nenin 6. E drejta për punë e garantuar në këtë nen vendos detyrimin për të garantuar të drejtën për të mos u privuar nga puna në mënyrë të padrejtë<sup>10</sup>. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, ndër të tjera në bindjet politike të personit.

*Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës*<sup>11</sup> *“Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”*, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e

<sup>8</sup> Shiko: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fabián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

<sup>9</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991

<sup>10</sup> Komenti i Përgjithshëm Nr.8, Komiteti për të Drejtat Sociale Ekonomike dhe Kulturore, paragrafi 4.

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

punësimin dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim ose favorizim i bërë në baza të caktuara, i cili ka efektin e zhdukjes në barazi dhe mundësi ose trajnim në punësim dhe profesion. Konventa garanton mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjeve politike.

*Karta Sociale Europiane*<sup>12</sup> parashikon të drejtën për punë (neni 1) si dhe të drejtën për mbrojtje në rastet e përfundimit të punësimin (neni 24). Në vijim, në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: “*Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Kartë do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakut të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindje ose statusi tjetër*”. *Karta Sociale Europiane*<sup>13</sup> në nenin 1, pika 2, parashikon: “ *Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>14</sup>.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, ankuesi A.LI, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Duke mbajtur në konsideratë se, diskriminues është vetëm trajtimi i diferencuar që nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet, në vijim Komisioneri do të vlerësojë nëse, trajtimi të cilit i është nënshtruar ankuesi ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se: “*7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.*” Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit në punësim dhe profesion e bën edhe Kodi i Punës, duke sanksionuar në nenin 9, pika 10, të tij se: “*10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë*”, si dhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon: “*2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë*

<sup>12</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>13</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>14</sup> Shih: *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, prg 30.

*diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.<sup>15</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkak i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*<sup>16</sup>”.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi e provuar se, ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultuan të provuara si deklaratimet e ankuesit për mospasje të bindjeve politike dhe mos angazhim e tij në asnjë strukturë apo forcë politike, dhe po ashtu, rezultuan të provuara bindjet politike dhe angazhimi politik në aktivitete dhe fushatën e zgjedhjeve vendore të

<sup>15</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>16</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).



datës 14 maj 2023 të Partisë Socialiste të titullarit të institucionit të Drejtorisë së së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Ankuesi pretendon se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i tij ka ardhur për shkak se ai nuk i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së titullarit të institucionit duke mos marrë pjesë në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore të zhvilluara në 14 maj 2024, mbështetës dhe pjesëmarrës i të cilës sikurse më sipër rezultoi e provuar ishte titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, z. H.Rr.

Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua ndonjë provë e drejtëpërdrejtë për të provuar kërkesën ndaj ankuesit për tu përfshirë dhe për të mbështetur fushatën e Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore të zhvilluara në 14 maj 2023.

Për trajtimin diskriminues, në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtëpërdrejta. Janë provat e tërthorta ato që, çojnë në fakte të cilat mund të shërbejnë si baza për arritjen e një përfundimi lidhur me një fakt vendimtar.

Në praktikën e saj, GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*<sup>17</sup>”.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioneri konstaton se, në Raportin Përfundimtar, në kuadër të zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023, Misioni i Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR-it) për Vëzhgimin e Zgjedhjeve<sup>18</sup>, konstaton se: “*MVZ-ja*<sup>19</sup> *e ODIHR-it mori një sërë raportimesh të besueshme në lidhje me rastet kur punonjësve të bashkisë iu tha të mbështesnin ose të votonin për PS-në ose kur ishin paralajmëruar të mos e mbështesnin opozitën. MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të tilla nga qarqet Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë.*”

Rezultoni se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i ankuesit, fillimisht me largimin e tij nga pozicioni i punës si magazinier në datën 1.7.2023 dhe më pas përfundimi i marrëdhënies së punës për pozicionin e punës teknik i mesëm në datën 25.8.2023, në të cilin ishte emëruar po në datën 1.7.2023, kanë ndodhur brenda një periudhe të shkurtër kohe, nga zhvillimi i zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri gjykon se, elementi kohë, përforcojnë lidhjen shkaksore midis shkakut të diskriminimit bindjeve politike, në rastin konkret të mospasjes së bindjeve politike dhe

<sup>17</sup> GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

<sup>18</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>, version shqip i Raportit, <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>, versioni anglisht i Raportit

<sup>19</sup> Shkurtim për Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ)



trajtimin të padrejtë dhe të disfavorshëm që i është nënshtruar ankuesi, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara *krijojnë prezumimin* se, ankuesi A.LI është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme, në lidhje me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, për shkak të bindjeve politike, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë .

Parimi i zhvendosjes/ndarjes së barrës së provës në çështjet e diskriminimit, është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës – “*praesumptio iuris tantum*”.

Në kushtet kur, jemi përpara një *prezumimi se diskriminimi ka ndodhur*, punëdhënësi Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , Bashkia Tiranë, *ka barrën e provës që të provojë të kundërtën*, pra që veprimet nuk përbëjnë diskriminim. Këtë, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , mund ta realizonte duke treguar se, nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të bindjeve politike dhe trajtimit të ankuesit, ose duke provuar se megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhte poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës, është kryer për shkak të bindjeve politike.

Gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik , Bashkia Tiranë nuk paraqiti asnjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se zgjidhja e marrëdhënies së punës për të dyja pozicionet, magazinier dhe më pas largimi përfundimtar nga pozicioni si teknik i mesëm, ka ndodhur për shkak të bindjeve politike. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Drejtorisë së Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesin A.LI, mbetet shkak i diskriminimit i pretenduar, pra bindjet politike, që në rastin konkret është mospasja e bindjeve politike nga ankuesi.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr.10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative mbi çdo punëdhënës që krijon, ndryshon apo i jep fund marrëdhënies së punës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret bindjet politike, ku përfshihet edhe mospasja ose mosdeklarimi i tyre, përbëjnë shkak diskriminues për përfundimin e marrëdhënies së punës me ankuesin, sa kohë që punëdhënësi/Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, Bashkia Tiranë ka dështuar të japë shpjegime alternative e të besueshme se largimi nga puna i ankuesit nuk është bërë për shkak të bindjeve politike ose se largimi është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

**Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , Bashkia Tiranë, e ka diskriminuar ankuesin A.LI, në të drejtën për punësim, pasi zgjidhja e marrëdhënies së punës nuk ka ndodhur bazuar në një shkak të ligjshëm, por për shkak të bindjeve politike. Për rrjedhojë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, ka shkelur dispozitat e Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 3, pikat 1 dhe 2, neni 5 dhe neni 12, pika 1, shkronja “c”.**

Ankuesi A.LI, ka kërkuar që Komisioneri të marrë masa për rikthimin e tij në pozicionin e punës magazinier ose në një pozicion tjetër të përshtatshëm për të.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri ka konstatuar se sjellja diskriminuese ndaj ankuesit konsiston pikërisht në përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit dhe largimin e tij nga puna. Për rrjedhojë edhe masa rregulluese duhet të jetë në funksion të rregullimit të situatës së diskriminimit. Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese, të shkaktuar si pasojë e largimit nga puna të ankuesit, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e rikthyer ankuesin në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të. Komisioneri çmon se rikthimi i ankuesit në punë, është një masë rregulluese, e cila është në përpjestim me gjendjen që ka shkaktuar vendosjen e kësaj mase, që në rastin konkret është largimi nga puna i ankuesit.

Komisioneri vlerëson se urdhërimi i punëdhënësit për marrjen e masave për të rikthyer punonjësën e larguar nga puna për shkaqe diskriminuese, nuk vjen në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Në nenin 9, pika 9, të Kodit të Punës sanksionohet: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.” Ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi, është ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në nenin 38 të këtij ligji, që rregullon procedurat e gjyqimit të padisë për diskriminim përpara gjykatës, ligji përcakton

se: “*Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme*”. Nëpërmjet këtij parashikimi, ligji është kujdesur të përcaktojë se, në rastet kur konstatohet se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ndodhur si pasojë e diskriminimit, një nga mënyrat e dëmshpërblimit është rikthimi i punonjësit në gjendjen e mëparshme. Komisioneri çmon se, rikthimi në gjendjen e mëparshme realizohet duke e rivendosur marrëdhënien e punësimit të ndërprerë për shkak të diskriminimit. Kodi i Punës, në mënyrë të shprehur referon në dispozitat e ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, si ligji i posaçëm që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj, përmes parashikimit në nenin 38 të tij, se dëmshpërblimi për diskriminimin përfshin ndër të tjera edhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, një të drejtën e personit që konstatohet se është larguar për shkaqe diskriminuese, që të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Pavarësisht se, rregullimet e mësipërme ligjore kanë të bëjnë me procedurat e shqyrtimit para gjykatës dhe jo përpara Komisionerit, ato tregojnë se, kuadri ligjor në fuqi ofron mbrojtje për rikthimin në punë të personit, i cili konstatohet se është larguar nga puna për shkaqe diskriminuese.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji, nuk do të ishte efektive nëse punëdhënësi nuk detyrohet të rivendosë marrëdhënien e punësimit, pasi me kushtin që të paguajë dëmshpërblimin për zgjidhje të marrëdhënies së punës në mënyrë të padrejtë, sipas parashikimeve përkatëse të Kodit të Punës, ai mund të largojë çdo punonjës bazuar në një shkak të mbrojtur nga legjislacioni.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 e 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit A.LI, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë, Bashkia Tiranë, të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin A.LI në pozicionin e punës “Magaznier” ose në një pozicion të barazvlefshëm me të ose të përshtatshëm për ankuesin.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Bashkia Tiranë , Bashkia Tiranë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Bindje politike  
Fusha: Punësim  
Lloji i vendimit: Diskriminim